

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Krimeve të Rënda- gjyqtari Nikollë Komani, kryetar i trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. B. nga fshati H., Komuna Gjakovë, për shkak të veprës penale të detyrimit nga nenin 340 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I nr. 231/2014 të datës 29.03.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë **28.04.2017**, në prezencën e Prokurores Shpresa Bakija, përfaqësuesit ligjor të dëmtuarit-të miturit P. Th., babait G. Th., të akuzuarit A. B. dhe mbrojtësit të tij M. S. avokat në Gjakovë, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. B.**, biri i H. dhe G., e gjinisë N., i lindur më datë ... në fshatin H., Komuna Gjakovë, i pamartuar, i pa punë, gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 11.09.2014 rreth orës 18,00/h në Gjakovë pikërisht në parkun e qytetit “Nëna Terezë” me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme për vete, kryen veprën penale të detyrimit, në atë mënyrë që gjersa i dëmtuari i mitur P.TH. kishte qenë duke qëndruar në parkun e qytetit kishte shkuar i pandehuri A. duke i kërkuar telefonin mobil ku i dëmtuari-i mitur ja kishte japur duke menduar se e kërkon vetëm për shërbim dhe me atë rast i pandehuri e kishte hequr SMS kartelën dhe i kishte thënë ”me bo me kërkuar këtë telefon menjëherë do ta bëj zi” me ç’ rast i dëmtuari-i mitur nga frika ishte larguar nga vendi i ngjarjes dhe menjëherë e ka lajmëruar policinë.

- me çka ka kryer veprën penale të detyrimit nga neni 340 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 6, 17, 41, 46, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 340 par. 1 të KPRK-së dhe nenit 233 dhe 365 të KPP-së, e:

G J Y K O N

Dënim me gjobë në shumën prej 600,00 € të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe **Dënim** me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajve, i cili dënim nuk do të

ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti do ti zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë ditëve) duke ia llogaritur **20,00 €** për një ditë burgimi.

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej **60,00 €** në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me aktakuzën PP/I. nr. 231/2014 të datës 29.03.2017 e ka akuzuar A. B. nga fshati H., Komuna Gjakovë, për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 329 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ku prezentë kanë qenë prokurorja Shpresa Bakija, përfaqësuesi ligjor i të dëmtuari të miturit P. Th., baba G. Th. i akuzuari A. B. dhe mbrojtësi i tij M. S. avokat në Gjakovë.

Me marrëveshjen PP/I nr. 231/2014 të datës 25.04.2017, e lidhur në mes të prokurores Shpresa Bakija, të akuzuarit A. B. dhe mbrojtësit të tij M. S. avokat në Gjakovë, është bërë rikualifikimi i veprës penale nga vepra penale e grabitjes nga neni 329 par. 1 të KPRK-së, në veprën penale të detyrimit nga neni 340 par. 1 të KPRK-së.

Prokurorja Shpresa Bakija ka deklaruar se fillimisht sipas marrëveshjes së arritur ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale e grabitjes nga neni 329 par. 1 të KPRK-së në veprën penale të detyrimit nga neni 340 par. 1 të KPRK-së, si dhe ka theksuar se mbetet në tërësi pranë marrëveshjes së arritur dhe kushteve të propozuara me marrëveshje ashtu që i ka propozuar gjykatës që të njëjtën marrëveshje ta aprovoi.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit-të miturit P. Th. baba G. Th. ka theksuar se e ka të qartë marrëveshjen e arritur, kushtet e përcaktuara me marrëveshje, andaj nuk e kundërshton marrëveshjen e arritur si dhe ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi pasi telefoni i është kthyer.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. B., avokati M. S. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrëveshjes së arritur dhe kushteve të përcaktuara me marrëveshje.

I akuzuari A. B. ka deklaruar se mbetet pranë marrëveshjes së arritur si dhe ka shtuar se i kërkon falje të dëmtuarit dhe premtun se më nuk do të kryen vepra penale, pasi ka qenë i ri dhe ka gabuar.

Gjykata pas dëgjimit të pretendimeve të prokurores Shpresa Bakija, përfaqësuesit ligjor të dëmtuarit të miturit P. Th., babait G. Th., të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij lidhur me marrëveshjen për pranim të fajësisë ka konstatuar se i akuzuari A. B. e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë sipas marrëveshjes së arritur, marrëveshja

është bërë në baza vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, i akuzuari nuk ka qenë i shtrënguar apo i detyruar për lidhjen e marrëveshje, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që janë bashkëngjitur aktakuzës, si dhe nuk ekziston asnjëra nga rrethanat për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale të parapara me nenin 253 par. 1 të KPP-së, andaj gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore dhe është e bazuar në nenin 233 par. 21 të KPP-së, dhe gjykata ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

Gjatë seancës për përcaktimin e dënimit prokurorja Shpresa Bakija, ka deklaruar se mbetet pranë dënimeve të propozuar në marrëveshjen për pranimin e fajësisë për veprën penale të detyrimit nga neni 340 par. 1 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënimi me gjobë në shumën prej 400-600,00 euro si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj gjerë në 14 (katërmëdhjetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër të re penale.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit, baba G. Th. nuk e ka kundërshtuar dënimin e propozuar me marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. B., avokati M. S. ka deklaruar se mbetet pranë dënimeve të propozuara me marrëveshjen për pranimin e fajësisë.

I akuzuari A. B. ka theksuar se mbetet pranë marrëveshjes dhe dënimeve të propozuara me marrëveshje.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata ka konstatuar se edhe më parë ka qenë i dënuar dhe atë në lëndë penale PKR. nr. 180/15 ka, për veprën penale lëndim i rëndë trupor me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, e 2 (dy), ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marrë parasysh pranimin e fajësisë, pendimin e tij, sjelljen korrektë gjatë seancës, faktin se me familjen e të dëmtuarit janë pajtuar, e i dëmtuari nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi, e të cilat rrethana lehtësuese ka ndikuar që gjykata përkundër faktit që i akuzuari ka qenë edhe më parë i dënuar, ta aprovoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ashtu që të akuzuarit sipas marrëveshjes së arritur ia ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumën prej 600,00 € si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohë së verifikimit në afatin prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër të re penale, me bindjen e plotë se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi që i dëmtuari të mos udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë pasi i dëmtuari gjatë seancës ka deklaruar se nuk kërkon kompensim dëmi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
PKR. nr. 38/17 datë 28.04.2017

Sekretarja Juridike
Mandushe Doli

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Nikollë Komani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.